



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2022/12 prot.

Datë 09.09.2024

V E N D I M
Nr. 1202/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.09.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1100/2024, datë 21.08.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-07795-06-03-2024, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje objektit ndërtimor për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, MK me afat 24 muaj”, me fond limit 122,786,742.45 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “R&T” SHPK & “I.B.S” SHPK, me NIPT (J61901094G) dhe NIPT (L61411012R), me adresë: Rruga “Luigj Gurakuqi”, Pallati 89. Shk.A, Kati 10, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni

4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 21.08.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1100/2024, datë 21.08.2024, ku vendosi:

[...]

1. Të mos pranojë ankimin elektronik me nr. A/2024/4354, datë 22.07.2024 dhe nr. Protokolli 2022/2024, datë 22.07.2024, të bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-07795-06-03-2024, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje objektit ndërtimor për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, MK me afat 24 muaj”, me fond limit 122,786,742.45 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Të mbyllë çështjen për ankimin elektronik me nr. A/2024/4410 dhe nr. Protokolli 2229/2024, datë 07.08.2024, të bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në zbatim të vendimit të KSHA-së Nr. 438/12 prot., datë 15.08.2024.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga bashkimi operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, ankimin elektronik me nr. A/2024/4354, datë 22.07.2024 dhe nr. Protokolli 2022/2024, datë 22.07.2024.
6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, për ankimin elektronik me nr. A/2024/4410 dhe nr. Protokolli 2229/2024, datë 07.08.2024.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 438/17 prot., datë 04.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 2022/9 prot., datë 06.09.2024, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 1100/2024, datë 21.08.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-07795-06-03-2024, me objekt: “*Shërbim mirëmbajtje objektit ndërtimor për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, MK me afat 24 muaj*”, me fond limit 122,786,742.45 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me anë të shkresës nr. 438/17 prot., datë 04.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 2022/9 prot., datë 06.09.2024, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 1100/2024, datë 21.08.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-07795-06-03-2024, me objekt: “*Shërbim mirëmbajtje objektit ndërtimor për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, MK me afat 24 muaj*”, me fond limit 122,786,742.45 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, në përputhje me vendimin K.P.P. 1100/2024, datë 21.08.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara, ka zbatuar vendimin K.P.P 1100/2024, datë 21.08.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-07795-06-03-2024, me objekt: “*Shërbim mirëmbajtje objektit ndërtimor për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, MK me afat 24 muaj*”, me fond limit 122,786,742.45 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

